



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 50 datë 15.05 2026

**PËR VENDOSJEN E STATUJËS SË OLLGA SHURAJA NË "PANTEONIN" NË
PARKUN "SHATRËVANI"**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8 pika 2, neni 9 pika 1/1.1 shkronja "b", pika 1/1.7 shkronja "b", neni 54 shkronja "ll" dhe neni 55 pika 2 dhe 6, si dhe të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 "Për sistemin e adresave" (i ndryshuar), neni 3, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 43, datë 02.07.2021 "Për krijimin e një "PANTEONI" në parkun "Shatërvani", si dhe në shqyrtim të kërkesës së Shoqatës Kulturore "Albania s'ka Problem", protokolluar me tonën me nr. 1691 prot , datë 08.05.2026 për vendosjen e bustit të znj. Ollga Shuraja në qytetin e Përmetit, Këshilli Bashkiak Përmet, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë vendosjen e statujës se Ollga Shuraja në "PANTEONIN" në parkun "Shatrivani".
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Perfshirjes Sociale , Arsim-Kulture,Sporte dhe Drejtoria e Urbanistikes, Planifikimit te Territorit, Sektorit Juridik dhe Prokurimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE



KRYETAR
Anila DHIMITRI